REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I FARMACISTËVE
KËSHILLI KOMBËTAR

Nr 600 Prot. **Tiranë, më 31/07/2015**

Drejtuar: Z. Besnik Dervishi
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Lënda: Ankesë

I nderuar Z. Dervishi!

Në ankesën që i kemi drejtuar institucionit tuaj në datën 08/06/2015 pas ankesave që ka pasur pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërsisë pas publikimit nga Ministria e Shëndetsisë dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të listës së farmacistëve me xhirot mujore të shprehura në vlerë monetare për secilin subjekt, në datën 17/06/2015 ju na keni kthyer përgjigje ku vlerësoni se emri i subjektit tregtar nuk konsiderohet si e dhene personale. Problemi i ankeses që kemi bërë ne nuk qëndron tek publikimi i emrave por tek vlera monetare e rimbursimit e publikuar, dhe vlera monetare e rimbursimit nuk eshte e publikuar në asnjë nga regjistrat elektronikë publikë të administruara dhe përpunuara nga Qëndra Kombëtare e Regjistrimit apo Qëndra Kombëtare e Licencimit.

Në bazë të ligjit nr.10383 datë 24/02/2011, i ndryshuar, në zbatim të pikës 2, të nenit 27, Fondi (FSDKSH) në cilësinë e kontrolluesit ka ngritur sisteme elektronike të cilat garantojnë sigurinë e të dhënave personale sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në vecanti të së drejtës së ruajtjes së jetës private.

Duke e konsideruar këtë si një shkelje të të dhënave personale të subjekteve, ashtu sic dhe ju vetë e keni cituar:

""Të dhëna personale" është cdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në vecanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të vecantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, **ekonomik**, kulturor apo social", ju kërkojmë edhe njëherë rishqyrtimin e ankesës dhe marrjen e masave ndaj institucioneve përkatëse, pasi nga verifikimet e bëra vazhdon akoma publikimi i listave me xhirot mujore të subjekteve farmaceutike nga institucionet e sipërpërmendura.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

PRESIDENTE
Diana TOMA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
URDHERI I FARMACISTEVE
KESHILLI KOMBETAR
TIRANE